



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Autoriteti i Konkurrencës shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Ekonomisë
Institucioni	Autoriteti i Konkurrencës
Nr. i Referencës	RN00011457
Kodi	RPC0005082
Data e njoftimit	14.04.2023
Afati për aplikim	05.05.2023 - 12.05.2023



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1.Monitoron dhe mbledhë informacione me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave për vlerësimin e kushteve të tregut, 2.Analizon informacionet e nevojshme mbi strukturën, sjelljen dhe performancën e tregut përkatës, 3.Inicon dhe realizon procedurat e inspektimit sipas Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, 4.Merr pjesë në kontrollin pa paralajmërim tek objektet afariste dhe objektet tjera, përmes urdhrit nga gjykata kompetente, në bashkëpunim me organet e rendit dhe të tjera, ndaj të gjitha atyre subjekteve që bien ndesh me ligjin, 5.Inicion procedurat për marrjen e masave të përkohshme kundër subjekteve të caktuara, kur ka rrezik për dëmtim të pariparueshëm të konkurrencës në tregun përkatës, 6.Realizon procedurat për mbledhjen e të dhënave dhe modeleve të analizave ekonomike, 7.Propozon bazën metodologjike për hulumtimin e konkurrencës së tregut duke u bazuar në ligj dhe akte nënligjore, 8.Ndërmerr aktivitetet e nevojshme në procesin e hetimit për identifikimin e marrëveshjeve të ndaluara - karteleva, abuzimin me pozitën dominuese, përqendrimet, praktikave të bashkërenduara si dhe procesin e vlerësimit të marrëveshjeve që kërkojnë përjashtim nga ndalimi (horizontal, vertikal dhe të liçencës sipas dispozitave të Ligjit), 9.Kryen vlerësimin ekonomik dhe ligjor të njoftimeve për përqendrim, ndikimin në konkurrencë pas përqendrimit, marrëveshjeve të ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese dhe analizën e tregut, siguron informacionet e domosdoshme nga palët, paraqitësit të iniciativës, si dhe respektimin e afateve kohore të përcaktuara në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore, 10.Harton raportin hetimor për rastet që ndjek dhe e dërgon tek Udhëheqësi i Divizionit, 11.Ruan konfidencialitetin zyrtar dhe afarist për informacionet e dokumentuara, të marra nga bizneset, institucionet publike, entet rregullatore, shoqatat profesionale e tregtare dhe palët tjera të përfshira ose jo në hetim, 12.Përfaqëson, promovon dhe shkëmben përvojat profesionale për konkurrencën, brenda dhe jashtë vendit si dhe njohuri nga legjisllacioni vendor dhe i BE-së. 13.Ngritë nivelin e vetëdijësimit dhe informimit për rolin e politikës së konkurrencës përmes avokimit dhe 14.Kryen edhe punë të tjera të cilat i kërkohen nga Kryetari, Komisioni, Drejtori i përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve dhe Udhëheqësit e Divizioneve.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar:
 - I/E diplomuar në Fakultetin Juridik ose Ekonomik,
 - Njohja e gjuhës angleze,
 - Përparësi kandidatët me titull Kontabilist i certifikuar dhe provim te Jurisprudences
- Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjisllacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;

- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0004728	RN00011080	Inspektor Hetues i Konkurrencës	Profesional 1	7	Autoriteti i Konkurrencës	Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut / Prishtinë	5

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

Përparësi kandidatët me njohuri nga fusha e TI-së, e veçanërisht:

- Të njohë programet e MS Office;
- Njohuri të mira në Data Science;
- Njohura të mira analitike të TI-së;
- Analiza të të dhënave Extradim dhe sortim të informacionit;
- Llogaritje matematikore të paraqitura në statistika; · Nxjerrja e ekstraktit të informacionit nga dokumente me sasi të mëdha të të dhënave dhe paraqitja e tyre në tabela statistikore; · Kujdeset për pajisjet e TI-së dhe funksionimin e tyre.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

E domosdoshme deshmia e punes profesionale ne fushen e kerkuar.

Çertifikate qe nuk jeni nen hetime.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

